



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:210399
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05611309

AA.nr.225/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Komuna e Klinës, të cilën me autorizim e përfaqëson B. B., kundër të paditurës Agjencioni Kosovar për Prona në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Veton Demi, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1371/2021, të datës 14.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses Komuna e Klinës, e datës 16.02.2024, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1371/21, i datës 14.12.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin e ankimuar e ka hedhë poshtë kërkesëpadinë e paditëses, Komuna e Klinës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi me nr. ... i datës ... i Qeverisë së Republikës së Serbisë – Komisionit për Çështje banesore në Beograd si e pasafatshme.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të LPK-së dhe LKA-së.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1, të Ligjit për konflikte administrative, (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ligj i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 16.12.2021 ka bërë parashtrësën lidhur me plotësimin e padisë me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi me numër ... i datës ... i Qeverisë së Republikës së Serbisë - Komisionit për Çështje banesore në Beograd.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka theksuar se paditësja me padinë e parashtruar ka theksuar se e paditura i'a kishte dorëzuar një numër banesash të braktisura paditësit përfshirë edhe paligjshmërinë lëndore, KPA duke u bazuar në kërkesën e Komunës së Klinës të dt.25.04.2012 për Përmbarrim të rastit të Ujdisë Gjyqësore me C.nr.247/2007 të datës 10.09.2007 për shkak se në Procesverbalin dhe Vendimin e datës ... për dorëzimin e pronave të braktisura Komunës së Klinës i janë specifikuar tri banesa duke përfshirë paluajtshmërinë lëndore me nr. ... ku i janë dhënë Komunës si prona të braktisura. Kjo ka ndodhur në kohën kur paraqitësi i kërkesës me nr.KPA... ka qenë në proces të shqyrtimit të Agjencisë. Pas kësaj, gjykata gjeti se me vendimin e vërtetuar të Komisionit të Agjencisë nr.KPCC/D/R.... i cili vendim është përmirësuar me vendimin e datës 09.12.2020 (në një fjali) i'u është njohur e drejta e shfrytëzimit të Pronës K. D. lidhur me pronën kontestuese, si dhe ka të drejtë në posedimin e pronës në fjalë. Nga provat e administruara gjykata ka vërejtur se paditësja Komuna e Klinës nuk e ka vërtetuar apo dëshmuar se ajo e ka fituar të drejtën e pronësisë nga bartësi i të drejtës në pronë. Pra, pa marrë parasysh se cilat prona i dorëzohen apo i janë dorëzuar paditësit, kjo nuk i ndalon palët me interes që ta ndjekin interesin e tyre pronësor në çdo rrugë të mundshme ligjore.

Lidhur me këtë gjykata gjeti se Vendimet përfundimtare të KPCC-së/HPCC-së janë të detyrueshme për zbatim sipas nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. Kjo do të thotë se, nëse parashtruesit të kërkesës i është aprovuar e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit të pronës, ajo e drejtë duhet të respektohet derisa nuk anulohet akti juridik me të cilin është fituar e drejta banesore. E drejta banesore e fituar ligjshëm mund të merret vetëm me anulimin e vendimit mbi ndarjen e banesës apo të kontratës për shfrytëzim, përmes procedurës dhe organit përkatës sipas dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Banimit të Kosovës, ku parashihet se asnjë e drejtë banimi në banesë shoqërore nuk mund të përfundoj jashtë kushteve të parapara me Rregulloren 2000/60.

Duke vlerësuar këtë gjendje faktike dhe duke marrë për bazë rekomandimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës si në Aktvendimin AA.nr.813/22 të datës 09.12.2022 lidhur me afatshmërinë e kërkesëpadisë, gjeti se padia e paditësit është e pasafatshme.

Neni 27 të Ligjit Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative (LKA), përcakton se:

“1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.

E në këtë rast, paditësja në këtë gjykatë e atakon vendimin me numër ... të datës ... të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Serbisë – Komisioni për Çështje Banesore në Beograd, e të cilin vendim

nuk e ka nxjerr e paditura e as nuk mund të ndikoj në ligjshmërinë e atij vendimi. Pra, një akt të nxjerrë para 25 viteve e më tepër.

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se padia e paditëses është e parashtruar pas afatit të paraparë ligjor konform dispozitave të lartcekura. Andaj, edhe konsideroi se padia duhet të hudhet siç përcaktohet me nenin 34 të LKA-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke e shqyrtuar aktvendimin e shkallës së parë, në bazë të ankesës dhe sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe nenit 194 të LPK-së të njëjtin në tërësi e konfirmon si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj, sepse edhe kolegji ashtu si gjykata e shkallës së parë vlerëson se paditësi ka lëshuar afatin për fillimin e procedurës gjyqësore në konflikt administrativ ashtu si parashihet me nenin 27 të LKA, padia ka mundur të paraqitet në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktit përfundimtar në procedurë administrative. Paditësi ka kërkuar anulimin e vendimit me numër ... të datës ... të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Serbisë – Komisioni për Çështje Banësore në Beograd, ndërsa paditësi ka ushtruar padi në gjykatë, pas afatit të paraparë ligjor.

Në raport me pretendimet e paditëses se, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, sepse dispozitivi i vendimit është i paqartë. Kolegji këtë pretendim e refuzon si të pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë aktvendimin e saj e ka mjaftë të qartë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore nga neni 164 të LPK-së. Andaj duke u bazuar në këtë kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji vlerëson, se në këtë çështje juridike administrative në procedurë gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë drejtë është vendosur çështja dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankueses, andaj janë të pa ndikim Pretendimet ankimore për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative juridike.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 209 par, b) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.225/2024, me datë 03.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi